R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE SIGURISË PUBLIKE

Nr. 2546/6 prot. Tiranë, më 27.10.2026

REKOMANDIM

Nr. 66, datë 27.10.2026

PËR KONTROLLUESIN

"QENDRA KOMBËTARE TERAPEUTIKE DHE REHABILITUESE PËR FËMIJËT"

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"[1] (në vijim "Ligji"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" (në vijim "Kodi i Procedurave Administrative"), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit "Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët" (në vijim "QKTRF" ose "Kontrolluesi"),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 182, datë 12.09.2026, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri"), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

[1] Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

1. QKTRF është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe ka si mision ofrimin e shërbimeve të fushën e shëndetit mendor, në lidhje me diagnostikimin, trajtimin, kujdesin terapeutik dhe rehabilitimin e aftësisë kufizuese për fëmijët nga 0-18 vjeç, nëpërmjet shërbimit ditor dhe ambulator, me kohëzgjatje të caktuar (hospitalizim). Emërtesa e këtij institucioni është ndryshuar me VKM-në nr. 558, datë 15.07.2020, në "Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët".

2. Kontrolluesi, bazuar në ligjin nr. 10 138, datë 11.05.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar, legjitimohet të përpunojë të dhëna personale, për kategoritë "të miturit me çrregullime shëndetësore dhe të shëndetit mendor", "familjarë të të miturve" dhe "punonjës".

   QKTRF, në funksion të veprimtarisë së saj, përpunon të dhëna personale dhe të dhëna sensitive, pjesë të dosjeve të të miturve të cilët kërkojnë shërbim mjekësor dhe psikologjik, ditor dhe ambulator, me një kohëzgjatje të caktuar. Kontrolluesi përpunon kategoritë e të dhënave personale, si: "emër", "atësia", "mbiemër", "data e lindjes", "nr. i identifikimit", "gjinia", "vendlindja", "adresa", "adresa emaili", "numri i telefonit", si dhe të dhëna sensitive, të tilla si: "kombësia", "përgjegjshmëria psikike", "gjendja shëndetësore" etj.

   Përpunimi i këtyre të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike, të administruara në format "*word*" dhe "*excel*".

3. QKTRF ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ Rregulloren e Brendshme nr. 288, datë 09.05.2023 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët".

   Nga analizimi i aktit të mësipërm konstatohet se në nenin 47 "Politikat e mbrojtjes, konfidencialitetit dhe integritetit të informacionit" janë parashikuar rregulla të përgjithshme në lidhje me konfidencialitetin e informacionit. Në këtë rregullore nuk parashikohet asnjë dispozitë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Gjithashtu konstatohet se Kontrolluesi nuk disponon rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj., në kundërshtim me nenet 27 dhe 28 të Ligjit dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale" (në vijim "Vendimi nr. 6").

4. Nga ana e grupit të hetimit u konstatua se të dhënat shëndetësore, përfshirë kartelat klinike të subjekteve të të dhënave, administrohen dhe ruhen në ambientet e zyrës së arkivit. Në çdo rast të paraqitjes së subjektit të të dhënave pranë Kontrolluesit për marrjen e shërbimit, kartela klinike tërhiqet nga mjeku ose specialisti që ofron shërbimin dhe, pas përfundimit të shërbimit, kthehet pranë zyrës së arkivit për ruajtje. Nga shqyrtimi i

dokumentacionit të administruar rezulton se kjo procedurë nuk është e përcaktuar dhe e formalizuar në aktet rregullatore të brendshme të Kontrolluesit.

Në këtë kontekst, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka përcaktuar rregulla dhe procedura organizative specifike për përpunimin e të dhënave sensitive (të dhënave shëndetësore), në veçanti lidhur me mënyrën e administrimit dhe ruajtjes së tyre, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, si dhe përcaktimin dhe kufizimin e niveleve të aksesit në këto të dhëna. Për rrjedhojë, rezulton se për këtë kategori të veçantë dhe sensitive të të dhënave personale nuk janë përcaktuar në mënyrë të dokumentuar masat organizative dhe fizike të nevojshme, duke mos siguruar një nivel të shtuar mbrojtjeje, në funksion të parandalimit të aksesit, përdorimit ose përpunimit të paautorizuar, në kundërshtim me kërkesat e neneve 9 dhe 28 të Ligjit, Udhëzimit nr. 2, datë 30.04.2025, të Komisionerit "Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore", si dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

5. Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 47 të Rregullores së Brendshme përcaktohet se: *"...informacioni përmbahet në dokumentacionin manual dhe ruhet në sistemin kompjuterik".* Lidhur me këtë përcaktim, përfaqësuesit e Kontrolluesit deklaruan se institucioni nuk disponon aktualisht një sistem kompjuterik nëpërmjet të cilit të administrohen, hidhen dhe përpunohen të dhëna personale. Për rrjedhojë, konstatohet një mospërputhje ndërmjet mënyrës së rregulluar në aktin e brendshëm dhe gjendjes faktike të proceseve të përpunimit të të dhënave personale, pasi Rregullorja e Brendshme referon përdorimin e një sistemi kompjuterik, ndërkohë që një sistem i tillë, sipas deklarimeve të Kontrolluesit, nuk është në përdorim. Kjo situatë tregon se rregullat e brendshme nuk janë përshtatur me proceset reale të përpunimit dhe nuk përcaktojnë në mënyrë të qartë, të saktë dhe të zbatueshme mënyrën e administrimit, ruajtjes, aksesimit dhe përpunimit të të dhënave personale në praktikë. Kontrolluesi nuk ka arritur të dokumentojë marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative, në përputhje me nenet 6, 27 dhe 28 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Gjithashtu, kjo situatë duhet të reflektohet në dokumentacionin që përshkruan veprimtaritë konkrete të përpunimit të kryera nga Kontrolluesi, në përputhje me kërkesat për dokumentimin dhe mbajtjen e regjistrit të veprimtarive të përpunimit, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Në ambientet e Kontrolluesit është vendosur një sistem video-survejimi (CCTV), i përbërë nga 19 kamera, njëra prej të cilave ka fushëpamje edhe në ambientet e jashtme të godinës. Kamerat janë të pozicionuara kryesisht në hapësirat e korridoreve. Pamjet e regjistruara shfaqen në kompjuterin e zëvendësdrejtorit të qendrës. Nga verifikimi i kryer rezultoi se akses në sistemin e video-survejimit ka zëvendësdrejtori i qendrës, i cili administron gjithashtu çelësat e pajisjes NVR dhe të pajisjes qendrore të sistemit të video-survejimit (CCTV).

   Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se nuk janë miratuar akte rregullatore të brendshme specifike për funksionimin e sistemit të video-survejimit, ku të përcaktohen qëllimi i përpunimit, nivelet dhe të drejtat e aksesit, si dhe afatet e ruajtjes së pamjeve. Për rrjedhojë, mungon dokumentimi i rregullave dhe masave organizative për administrimin dhe kontrollin e aksesit në sistem, në kundërshtim me kërkesat e nenit 28

të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025, të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejimit".

7. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në terren, konstatohet se në ambientet e Kontrolluesit nuk janë vendosur tabela njoftuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), me elementet informuese sipas modelit standard të miratuar, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave dhe të drejtat që ata gëzojnë lidhur me përpunimin e të dhënave imazhe/video nëpërmjet sistemit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

8. Nga shqyrtimi i Rregullores së Brendshme, si dhe nga analizimi i akteve të tjera të vendosura në dispozicion nga Kontrolluesi, konstatohet se në asnjë dispozitë të tyre nuk janë përcaktuar afate të qarta dhe konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale. Për më tepër, nga ana e Kontrolluesit nuk është vendosur në dispozicion asnjë akt apo formë që dëshmon asgjësimin e të dhënave apo dokumentacionit të administruar gjatë veprimtarisë së tij.

   Nga ana e grupit të hetimit administrativ është konstatuar se Kontrolluesi ruan dhe administron dokumentacion në arkivin e tij fizik që nga viti 2001.

   Mungesa e përcaktimit të afateve konsiston në shkelje të detyrimeve të parashikuara në pikën 5 të nenit 6 të Ligjit, si dhe pikën 4 të nenit 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 30.04.2025 "Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore".

9. Gjithashtu konstatohet se Kontrolluesi, pavarësisht se ka caktuar Nëpunësin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO), rezulton se nuk ka marrë masa për trajnimin e tij dhe të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, situatë faktike e cila nuk paraqitet në përputhje me parashikimet e shkronjave "c" dhe "ç" të nenit 34 të Ligjit dhe pikës 2 të nenit 5 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

   Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

   Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitojë pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit. Në vijim, Kontrolluesi nuk ka paraqitur pretendime mbi konstatimet e përcaktuara në procesverbal.

PËR KËTO ARSYE,

Në zbatim të neneve 6, 9, 13, 27, 28 dhe 34 të Ligjit, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Kontrolluesi të rishikojë, të hartojë dhe të miratojë rregulla dhe procedura të posaçme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në përputhje me veprimtaritë konkrete dhe mënyrat faktike të përpunimit. Në këtë kuadër, Kontrolluesi të identifikojë dhe të rishikojë referencat ndaj sistemeve apo proceseve të përpunimit që nuk përdoren më, duke i hequr ose përditësuar ato sipas rastit, si dhe të dokumentojë veprimtaritë e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me parimet e përpunimit dhe detyrimet përkatëse të parashikuara në nenet 6, 27 dhe 28 të Ligjit dhe Vendimin nr. 6 të Komisionerit.

2. Kontrolluesi të hartojë dhe të dokumentojë procedura organizative dhe fizike për administrimin e kartelave klinike dhe të dhënave shëndetësore, duke përcaktuar mënyrën e tërheqjes dhe kthimit të tyre në arkiv, personat e autorizuar, nivelet e aksesit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, si dhe mënyrën e parandalimit të aksesit ose përdorimit të paautorizuar, në përputhje me nenet 9 dhe 28 të Ligjit, Udhëzimin nr. 2 të Komisionerit dhe Vendimin nr. 6 të Komisionerit.

3. Kontrolluesi të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë rregulla e procedura të brendshme për administrimin e sistemit të video-survejimit (CCTV), duke përcaktuar qartë qëllimin e përpunimit, personat e autorizuar, nivelet dhe të drejtat e aksesit, afatet, administrimin e pajisjeve, mënyrën e aksesimit dhe të përdorimit të pamjeve, si dhe procedurat për vënien e tyre në dispozicion të subjekteve të autorizuara. Gjithashtu, të vendosë tabela informuese në vende të dukshme, përpara hyrjes në zonat e mbikëqyrura, të cilat të përmbajnë informacionin e nevojshëm për transparencën e përpunimit dhe ushtrimin e të drejtave nga subjektet e të dhënave, në përputhje me kërkesat ligjore. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e procedurave për rishikimin periodik të afateve të ruajtjes dhe për fshirjen ose, kur është e zbatueshme, anonimizimin e të dhënave pas përmbushjes së qëllimit të përpunimit, duke dokumentuar veprimet e kryera, në përputhje me nenet 13 dhe 28, pikën 5 të nenit 6 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

4. Kontrolluesi të marrë masa për garantimin e trajnimit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO), si dhe të punonjësve të cilët, në kuadër të ushtrimit të detyrave funksionale, kanë akses në të dhënat personale ose kryejnë veprimtari përpunimi të tyre. Trajnimi të përshtatet me përgjegjësitë dhe proceset konkrete të përpunimit që realizon secila kategori punonjësish, me qëllim rritjen e njohurive mbi detyrimet ligjore, zbatimin e masave të sigurisë dhe garantimin e një përpunimi të ligjshëm të të dhënave personale, në përputhje me shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 1 të nenit 34 të Ligjit.

5. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:

   i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 1 dhe 2 më sipër;
   ii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 3 më sipër;
   iii) vazhdimisht detyrimin e treguar në pikën 4 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

7. Komisioneri, bazuar në shkronjën “a”, pika 2 e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 27.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi